



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE  
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR  
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

**Numri:** KSC-BC-2020-07  
**Prokurori k. Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt**

**Para:** Gjykatësit të Vetëm  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratorja:** Dr. Fidelma Donlon

**Pjesëmarrësi parashtrues:** Prokurori i Specializuar

**Data:** 7 tetor 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Parashtrimet e Prokurorisë për gjuhën e punës në KSC-BC-2020-07**

---

**Zyra e Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtësit për z. Gucati**

Xhonatan Elistan Ris

**Mbrojtësit kujdestar për z.**

**Haradinaj**

Bastian Martens

## I. HYRJE

1. Në përputhje me Urdhrin e Gjykatësit të Vetëm,<sup>1</sup> nenin 20 të Ligjit,<sup>2</sup> dhe rregullën 8(3) të Rregullores,<sup>3</sup> Zyra e Prokurorit të Specializuar ('ZPS') paraqet parashtrime me shkrim për gjuhën e punës në procedimin KSC-BC-2020-07.
2. ZPS-ja parashtron se anglishtja duhet të jetë gjuha e punës në procedimin KSC-BC-2020-07, me përkthim përkatës me shkrim dhe me gojë në shqipe për secilin nga të dyshuarit.<sup>4</sup>

## II. PARASHTRIMET

3. Ndonëse e vetëdijshme për tri gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar,<sup>5</sup> ZPS-ja argumenton se caktimi i anglishtes si gjuhë e punës në çështjen KSC-BC-2020-07 do të mundësojë procedim efikas dhe do të reflektojë shpërndarje praktike dhe të përgjegjshme të kapaciteteve.<sup>6</sup>
4. ZPS-ja ka kapacitete të brendshme të kufizuara për përkthim me shkrim dhe me gojë. Këto kapacitete duhet të angazhohen në aktiviteteve hetimore në zhvillim e sipër në një numër çështjesh, dhe në përpunimin e provave, duke përfshirë edhe ato që kanë lidhje me obligimet për dhënien e informacionit, në procedimin KSC-BC-2020-07 dhe në procese të tjera.<sup>7</sup> Devijimi i këtyre kapaciteteve të kufizuara për përpunimin e

---

<sup>1</sup> Urdhri për parashtrime për gjuhën e punës në procedimin KSC-BC-2020-07/F00035, 30 shtator 2020, Publike ('Urdhri).

<sup>2</sup> Ligji Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015 ('Ligjit'). Të gjitha referimet 'neni' ose 'nenet' këtu i referohen neneve të Ligjit, përveç nëse është saktësuar ndryshe.

<sup>3</sup> Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, 2 qershor 2020 ('Rregullorja'). Të gjitha referimet 'rregulla' ose 'rregullat' këtu i referohen Rregullores, përveç nëse është saktësuar ndryshe.

<sup>4</sup> Rregulla 8. *Shih gjithashtu* përkatësisht transkriptet e 29 shtatorit 2020 dhe 1 tetorit 2020, ku secili prej të dyshuarve konfirmon se e kupton gjuhën shqipe.

<sup>5</sup> Neni 20; Rregulla 8(1).

<sup>6</sup> STL, *The Prosecutor v. Salim Jamil Ayyash*, STL-18-01/I/PTJ, *Décision relative à l'emploi des langues*, 22 October 2019 para.16; STL, *The Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-01/I/PTJ, *Decision on Languages in the Case of Ayyash et al.*, 16 September 2011, para.32 ('Duke marrë parasysh sa më lart, gjykatësi I procedurës paraprake arrin në përfundimin se ndonëse tri gjuhët zyrtare të Tribunalit - arabishtja, anglishtja dhe frëngjishtja – gëzojnë status të barabartë, gjithsesi faktori kohor dhe kapacitetet e kufizuara përligjin një qasje praktike për modalitetet e përdorimit të gjuhës').

<sup>7</sup> *Shih* rregullën 102 dhe 103.

parashtrimeve me shkrim, ose për çështje të lidhura me to, në çështjen KSC-BC-2020-07, do të ishte një barrë e rëndë me pasoja të mundshme negative për kohëzgjatjen e procedimit.

5. Disa faktorë të tjerë gjithashtu peshojnë në favor të caktimit të anglishtes si gjuhë pune. E para, siç është theksuar në Urdhër,<sup>8</sup> i tërë procedimi deri tani është kryer në anglishte. Kjo përfshin edhe paraqitjen e parë të secilit nga të dyshuarit, përkatësisht më 29 shtator dhe 1 tetor 2020, si dhe të gjitha parashtrimet e protokolluara në këtë procedim, duke përfshirë dhe ato të bëra në emër të secilit të dyshuar. Në fakt, mbrojtësi i specializuar për z. Gucati tashmë ka bërë të ditur se pajtohet që anglishtja duhet të mbetet gjuha e punës për këtë procedim.<sup>9</sup>

6. Caktimi i anglishtes si gjuha e punës në çështjen KSC-BC-2020-07 do të garantojë në këtë mënyrë efikasitetin e procedimit dhe, në të njëjtën kohë, do të respektojë plotësisht të drejtat e të dyshuarve.

**Numri i fjalëve (në origjinal): 508**

/nënshkrim/

**Xhek Smith**  
**Prokurori i Specializuar**

E mërkurë, 7 tetor 2020  
Në Hagë, Holandë

---

<sup>8</sup> Urdhri, KSC-BC-2020-07/F00035, para. 8.

<sup>9</sup> Parashtrimet për gjuhën e punës në procedimin KSC-BC-2020-07/F00041, 30 shtator 2020.